



IPVQ



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TE VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVE

MINISTRIA E DREJTËSISE
MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE

Nr. Br. No. 01-1457

Data/Datum/Date 24.07.07
PRISHTINË / A

Memorandum i Mirëkuptimit

në mes të

Ministrisë së Drejtësisë

dhe

Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut

për projektin :

“Mbledhja, sistemimi, përpunimi dhe publikimi i të dhënave për krimet e luftës si dhe krimeve kundër njerëzimit të kryera në Kosovë gjatë viteve 1998/1999”

Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë, dhe duke pasur parasysh Rregulloret e UNMIK-ut nr. 2005/53 dhe 2006/26, mbi themelimin e Ministrisë së Drejtësisë, përkatësisht Shtojcën XV, Ministria e Drejtësisë (MD) dhe Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNJ) me anë të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit pajtohen të punojnë bashkërisht në realizimin e projektit “Mbledhja, sistemimi, përpunimi dhe publikimi i të dhënave për krimet e luftës si dhe krimeve kundër njerëzimit të kryera në Kosovë gjatë viteve 1998/1999”, në tërësi, sipas dokumentit të bashkëngjitur këtij memorandumi (shtojca A).

Neni 1 Palët

1.1 Palë ne këtë Memorandum janë:

- (a) Ministria Drejtësisë (MD), dhe
- (b) Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNJ).

Neni 2 Qëllimi

2.1 Qëllimi i këtij Memorandumi është të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e palëve lidhur me implementimin e projektit “Mbledhja, sistemimi, përpunimi dhe publikimi i të dhënave për krimet e luftës si dhe krimeve kundër njerëzimit të kryera në Kosovë gjatë viteve 1998/1999” siç është përcaktuar në projekt propozim i cili është bashkangjitur në aneksin A dhe i cili është pjesë përbërëse e memorandumit.

Neni 3 Detyrimet e Ministrisë së Drejtësisë-së

- 3.1 Ministria e Drejtësisë do të sigurojë shumën e mjeteve financiare në vlerë prej 75,000.00 Euro për implementimin e projektit;
- 3.2 Shuma e mjeteve financiare do të transferohet nga MD në llogarinë bankare të KMDLNJ-së në bazë të kërkesave të implementuesit dhe do të përdoret vetëm për nevoja të projektit ashtu siç është e cekur në kritere e parapara në aneksin A.
- 3.3 Mjetet financiare do të transferohen sipas fazave të realizimit të projektit.
- 3.4 Ministria e Drejtësisë, sipas kërkesës së KMDLNJ-së dhe me qëllim të realizimit në mënyrë sa më të suksesshme të projektit në fjalë, do të ofrojë ndihmë tjetër shtesë sipas mundësisë dhe nevojës.

Neni 4 Detyrimet e KMDLNJ -së

- 4.1 KMDLNJ siguron që, me plotësimin e kushteve nga ana e MD të parapara në këtë memorandum, projekti do të kryhet deri në fund të muajit nëntor 2007, me fleksibilitet maksimal, dy muaj pas afatit të paraparë.
- 4.2 KMDLNJ është e detyruar që të gjitha furnizimet e mallrave dhe shërbimeve t'i kontraktojë me çmimet reale të tregut dhe gjatë kontraktimit të zhvillojë procedura konkurruese dhe transparente. Kontraktimi i furnizimeve të mallrave dhe

shërbimeve do të bëhet nga komisioni i përbashkët që do të formohet për këtë qëllim.

4.3 KMDLNJ do të implementojë projektin me përmbushjen e obligimeve të parapara në aneksin A dhe do të ofrojë:

- (a) Raport narrativ mujor për aktivitetet e kryera dhe planifikimi i aktiviteteve për muajin vijues
- (b) Raportit do t'i bashkëngjitet edhe dokumentacioni i nevojshëm i kontraktimit të mallrave dhe shërbimeve siç janë kontratat, faturat, dëshmitë e pagesës së faturave, etj.
- (c) Do të informoj për gjërat në vazhdimësi që do të pasojnë si dhe vlerësimi i projektit si është duke u implementuar.
- (d) Do t'i dorëzojë te Ministria e Drejtësisë, sipas marrëveshjes me KMDLNJ ekzemplarët (numri përcaktohet midis Ministrisë së Drejtësisë dhe KMDLNJ – së) e shtypur te Monografisë, në afat prej pesë (5) ditësh pas shtypjes.
- (e) KMDLNJ obligohet që në të gjitha komunikimet e shkruara si kërkesa, raporte, plane pune, komunikata për mediat e shkruara dhe elektronike dhe në shkresa tjera që kanë të bëjnë me projektin në fjalë, ta paraqesë Qeverinë e Kosovës dhe Ministrinë e Drejtësisë si donatorë, bashkëpunëtor dhe ndihmës të këtij projekti.

Neni 5 Autorizimet

- 5.1 Palët do të garantojnë që projekti të implementohet në pajtim me këtë Memorandum;
- 5.2 Palët pajtojnë që të formojnë një komision të përbashkët prej pesë (5) anëtarëve për përcjelljen dhe realizimin e këtij projekti.
- 5.3 Komisioni do të përbëhet nga tre (3) anëtarë nga KMDLNJ dhe dy (2) anëtarë nga Ministria e Drejtësisë.
- 5.4 Anëtarët që propozohen për këtë komision duhet të kenë njohuri të mjaftueshme të çështjeve financiare, prokurimit, juridike, etj.
- 5.4 Komisioni është përgjegjës për hartimin dokumentacionit të nevojshëm për zhvillimin e procedurave të kontraktimit të furnizimeve me mallra dhe shërbime si dhe pjesëmarrjes në vlerësimin dhe përzgjedhjen e furnizimeve me mallra dhe shërbime.
- 5.5 Secila palë do të jetë e lirë që ta zbatojë këtë marrëveshje në mënyrë të lirë dhe pavarur, duke respektuar të drejtat dhe detyrimet që dalin nga ky memorandum.

Neni 6 Mosmarrëveshjet

- 6.1 Çdo mosmarrëveshje në lidhje me këtë Memorandum, shkelje, shuarje, anulim, ose shfuqizim, do të zgjidhet përmes negociatave në mes vetë palëve.

Neni 7 Anulimi

- 7.1 Palët mund të japin vërejtje me shkrim për anulimin e këtij memorandumi në rastet kur pala tjetër në Memorandum, ka dështuar të përmbushë obligimet e parapara në këtë Memorandum.
- 7.2 Palës tjetër do t'i ipet kohë prej dy javësh që të përmbushë detyrimet në të cilat ka dështuar, në mënyrë që të evitohet anulimi i Memorandumit.
- 7.3 Nëse në fund të periudhës dy javore të mëtejme, pas vërtetimit të njoftimit me shkrim, pala nuk i mënjanon shkaqet që kanë ndikuar në mospërmbushjen e detyrimeve të saja, pala tjetër ka të drejtë në anulimin e menjëhershëm të këtij Memorandumi.
- 7.4 Ministria e Drejtësisë, konkretisht e ruan të drejtën që të bëjë anulimin e këtij Memorandumi me njoftim paraprak katër javor me herët nëse detyrimet financiare e kërkojnë një veprim të tillë.

Neni 8 Pronësia

- 8.1 Pronësinë mbi Monografinë e përgatitur e posedon Ministria e Drejtësisë.
- 8.2 E drejta e autorësisë së Monografisë i takon KMDLNJ-së.
- 8.3 Ekземplaret e shtypur të Monografisë janë pronë e Ministrisë së Drejtësisë.
- 8.4 Ministria e Drejtësisë ka të drejtë të bëjë publikimin, ri-publikimin dhe shpërndarjen e Monografisë.
- 8.5 KMDLNJ ka të drejtë të bëjë publikimin, ri-publikimin dhe shpërndarjen e Monografisë vetëm pasi të ketë marrë lejen paraprake të MD-së.
- 8.6 Monografia në fjalë, e botuar dhe ribotuar si nga MD-ja ashtu edhe nga KMDLNJ-ja, sipas paragrafëve 8.4 dhe 8.5 të këtij neni, në asnjë mënyrë nuk mund të shpërndahet për përfitime komerciale.
- 8.7 Dizajni i kopertinave të Monografisë përcaktohet nga Komisioni i përbashkët por ai duhet të përmbajë logot e të dy palëve të përfshira.


Neni 9 Kohëzgjatja

Ky memorandum hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga ana e Ministrit të Drejtësisë dhe Kryetarit të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut.

Neni 10
Gjuha


Gjuha e përdorur në këtë memorandum është gjuha shqipe dhe serbe.

Për Ministrinë e Drejtësisë:


Jonuz Salihaj
Ministër i Drejtësisë

Data: 24/07/2007

Për KMDLNJ:


Prof. Dr. Pajazit Nushi
Kryetar i KMDLNJ

Data: 24/07/2007



IPVQ



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TE VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVE

Aneksi I

Nr	Përshkrimi	Sasia	Periudha e angazhimit (muaj)	Çmimi	Vlera
01	Udhëheqësi i Projektit	1	6	400.00	2.400.00
02	Hulumtues terreni	16	4	300.00	19.200.00
03	Vozitës	1	6	200.00	1.200.00
04	Kontabilist	1	6	250.00	1.500.00
05	Punëtor administrativ për sistemimin e materialit	1	5	200.00	1.000.00
06	Ekspert te ndryshëm				10.000.00
07	Shpenzime terreni				7.000.00
08	Shpenzime telefoni				2.500.00
09	Material shpenzues për zyre				1.600.00
10	Shpenzimet për foto				1.500.00
11	Shpenzimet për filmime				6.300.00
	Gjithsej Faza e I				54.200.00
01	Përkthimi shqip- serbisht				4.200.00
02	Përkthimi shqip-anglisht				4.800.00
03	Korrektuara gjuhësore - shqip, serbisht, anglisht				3.600.00
04	Thyerja kompjuterike				2.400.00
	Gjithsej faza e II				15.000.00
01	Botimi Shqip	200		12.00	2.400.00
02	Botimi Anglisht	100		12.00	1.200.00
03	Botimi Serbisht	100		12.00	1.200.00
	Gjithsej Faza e III				4.800.00
01	Shpenzime për auditim				1.000.00
	Gjithsej Faza e IV				1.000.00
	Totali i Projektit:				75.000.00